



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ Datë ____ . ____ .2026

PËR

“PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE LIDHUR ME VKM-NË NR. 329, DATË 22.5.2019, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË BASHKËRENDIMIT TË PUNËS SË BASHKIVE ME AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS, PËR REGJISTRIMIN E TROJEVE TË DHËNA PËR NDËRTIM NGA NJËSITË E QEVERISJES VENDORE DHE PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE JURIDIKE TË PRONËSISË MBI KËTO TROJE, PËR EFEKT REGJISTRIMI” DHE PËR LIDHJEN E KONTRATAVE PARA NOTERIT PËR 2 (DY) FAMILJE.

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM Nr.329, datë 22.5.2019, “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi” dhe në Ligjin Nr.7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” neni 83 i tij, si dhe bazuar në relacionin e paraqitur e me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të përfundohen procedurat për lidhjen e kontratës së shitjes së truallit të noteri lidhur me VKM Nr.329 datë 22.05.2019 për 2 (dy) familjet si më poshtë :
 - a) Fuat FICO
 - b) Roland FICO
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Urbanistikës/Planifikimit të Territorit/Sektorit Juridik dhe Prokurimeve.
3. Ky vendim, pas miratimit nga ana e këshillit Bashkiak Përmet, hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

KRYETARI I BASHKISË
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Përmet, më __. __. 2026

RELACION
PËR

“PËRFUNDIMIN E PROCEDURAVE LIDHUR ME VKM-NË NR. 329, DATË 22.5.2019, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË BASHKËRENDIMIT TË PUNËS SË BASHKIVE ME AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS, PËR REGJISTRIMIN E TROJEVE TË DHËNA PËR NDËRTIM NGA NJËSITË E QEVERISJES VENDORE DHE PËR RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE JURIDIKE TË PRONËSISË MBI KËTO TROJE, PËR EFEKT REGJISTRIMI” DHE PËR LIDHJEN E KONTRATAVE PARA NOTERIT PËR 2 (DY) FAMILJE”.

KËSHILLIT TË BASHKISË

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Bashkisë,

Pranë Bashkisë Përmet janë paraqitur kërkesa nga qytetarë të ndryshëm mbi rregjistrimin e pronave të tyre, objekt i VKM-së Nr.329, datë 22.5.2019, “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi”.

Objekt i këtij vendimi janë tokat e dhëna për qëllime ndërtimi nga bashkitë, ish-komunat dhe ish-këshillat e rretheve (në vijim të quajtura "organe vendore"), pas datës 10.8.1991 deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 24/2012, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10270, datë 22.4.2010, "Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij”.

Shqetësimi i këtyre qytetarëve vjen për shkak të mosregjistrimit të kësaj kategorie pranë Drejtorisë Vendore të ASHK-së për arsye se mungon kontrata e shitjes e lidhur përpara noterit publik dhe në përputhje me përcaktimet e bëra në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, Neni 83 i tij citon : “*Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm. Është i pavlefshëm veprimi juridik që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht nga ligji*”.



Kjo VKM ka për qëllim heqjen e kufizimeve nga regjistri i pasurive të paluajtshme dhe regjistrimin e tyre në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Kanë të drejtë të përfitojnë nga dispozitat e këtij vendimi të gjitha subjektet për të cilat është miratuar të paktën vendimi i këshillit të organit vendor për dhënien e truallit për ndërtim.

Kjo procedurë nis me kërkesë të subjektit të interesuar duke paraqitur gjithë dokumentacionin që ai disponon lidhur me këtë truall, dhe Bashkia vazhdon me shqyrtimin e dokumentacionit rast pas rasti, duke ngritur nje grup pune i cili do të merret me, plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, Akt-Vlerësimin,Relacionin, Vendimin dhe Kontratën.

Njësia përgjegjëse për ndjekjen e procedurës për regjistrimin dhe rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë për trojet e dhëna për ndërtim, pasi ka verifikuar të gjitha dosjet e kërkuësve dhe i ka plotësuar ato, paraqet materialin në Këshillin e Bashkisë për miratim sipas tabelës:

Nr.	EMËR MBIEMËR	ADRESA
1	FUAT FICO	Lagjja Mejden, Përmet
2	ROLAND FICO	Lagjja Mejden, Përmet

Për sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Përmet, që të votojë pro miratimit të këtij projekt-vendimi sipas materialit që gjenden në dosjen e secilit këshilltar.

Bashkangjitur do të gjeni;

1. Z.Fuat FICO

1. Kërkesa e Z.Fuat Fico, Nr 1067 Prot, datë 17.03.2026.
2. Fotokopje e kartës së identitetit .
3. Vendim Nr.9 datë 02.03.2004 “Mbi Shqyrtimin Për Miratimin e Shpërndarjes së Shesheve të Ndërtimit...”
4. Leje Ndërtimi.
5. Vendim Nr.9 datë 26.07.2004 i K.RR.T “Për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij”.
6. Planimetri e Sheshit të Ndërtimit miratuar nga Kryetari i K.RR.T të Bashkisë Përmet.
7. Vendim Nr.9 datë 26.07.2004 “Për miratimin e sheshit dhe lejes së ndërtimit”
8. Mandat arkëtim A-161 me Nr.vepr : 278238, datë 26.07.2005 në vlerën 32 200 lekë.
9. Planëvendosje aktuale e truallit të z.Fuat Fico nga topograf i licensuar A.Bakushi.



Z.Roland FICO

1. Kërkesa e Z.Roland Fico, Nr 1068 Prot, datë 17.03.2026.
2. Fotokopje e kartës së identitetit .
3. Vendim Nr.9 datë 02.03.2004 “Mbi Shqyrtimin Për Miratimin e Shpërndarjes së Shesheve të Ndërtimit...”
4. Leje Ndërtimi.
5. Vendim Nr.9 datë 26.07.2004 i K.RR.T “Për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij”.
6. Planimetri e Sheshit të Ndërtimit miratuar nga Kryetari i K.RR.T të Bashkisë Përmet.
7. Vendim Nr.9 datë 26.07.2004 “Për miratimin e sheshit dhe lejes së ndërtimit”
8. Mandat arkëtim A-161 me Nr.vepr : 278222, datë 26.07.2005 në vlerën 32 200 lekë.
9. Planëvendosje aktuale e truallit të z.Roland Fico nga topograf i licensuar A.Bakushi.

Në bazë të sa më sipër, i propozohet Këshillit Bashkiak Përmet miratimi i vendimit:

“Për Përfundimin e Procedurave lidhur me VKM-në Nr. 329, Datë 22.5.2019, “Për Përcaktimin e Rregullave të Bashkërendimit të Punës së Bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Për Regjistrimin e Trojeve të Dhëna për Ndërtim nga Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe Për Rregullimin e Marrëdhënieve Juridike të Pronësisë Mbi Këto Troje, Për Efekt Regjistrimi” dhe për Lidhjen e Kontratave para Noterit për 2(Dy) Familje”.

Konceptoi : **K.Lile**

P.Mara

Pranoi : **E.Kushe**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ Datë _____ 2026

PËR

“PËRDORIMIN E FONDIT PËR EMERGJENCAT CIVILE”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, Ligjit Nr. 10296 dt.8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin,i ndryshuar, Ligjit Nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore",i ndryshuar, Ligjit Nr. 87/2025 “Për Buxhetin e vitit 2026”, Vendimin e KB Nr.113 datë 17.12.2025 “Për Buxhetin e Bashkisë Përmet viti 2026”,i ndryshuar,Ligjit Nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”,VKM-së Nr.414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”e ndryshuar,VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”,VKB-së Nr.91 datë 22.10.2025 “Për miratimin e “Planit Vendor për Emergjencat Civile Bashkia Përmet 2025-2028”,në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Nr.6 datë 09.01.2026 “Për ngritjen e grupit të punës për konstatimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimi i ujrave dhe masive inertesh në Bashkinë Përmet” dhe Urdhrit Nr.14 datë 15.01.2026 “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimi i ujrave dhe masive inertesh në Bashkinë Përmet” si dhe bazuar në shkresën Nr.429/6 prot. datë 15.04.2026 të Ministrisë së Mbrojtjes mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile dhe në kërkesat e disa qytetarëve në Bashkinë Përmet për konstatim dhe vlerësim dëmi, në relacionin e paraqitur e me propozim të Kryetarit të Bashkisë ,

VENDOSI:

1. Të miratojë përdorimin e fondit nga emergjencat civile për 8 (tetë) familje të prekura në vlerën **2 029 707** (dy milionë e njëzetë e nëntëmijë e shtatëqind e shtatë) lekë.
2. Fondet për mbulimin e këtyre shpenzimeve do të përballohen nga struktura buxhetore :
 - 17.10910.01.604.91707AB në vlerën **2 029 707** (dy milionë e njëzetë e nëntëmijë e shtatëqind e shtatë) lekë, për 8 (tetë) familjet të paraqitura në tabelën si më poshtë :



Nr.	EMËR/MBIEMËR	VLERA TOTALE
1	ESAT HARKA	51 580.56
2	ARBEN ISUFI	644 154.34
3	XHEMAL CANO	663 519.79
4	THOMA ZHULATI	120 618.16
5	NAPOLON TICE	151 031.95
6	SOSE DHËMBI	51 352.34
7	YZEIR NIKOLLARI	117 027.59
8	VJOLLCA KUKURECI	230 422.27
	TOTALI	2 029 707

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Buxhet-Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektori i Mbrojtjes dhe Emergjencave Civile.
4. Ky vendim, pas miratimit nga ana e këshillit Bashkiak Përmet, hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

KRYETARI BASHKISË

Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

RELACION
PËR
“PËRDORIMIN E FONDIT PËR EMERGJENCAT CIVILE ”

Përmet, më ____ . ____ .2026

1. Titulli dhe Referencat Administrative

Projekt-vendimi “Për përdorimin e fondit për emergjencat civile” paraqitet për miratim në Këshillin Bashkiak Përmet, në mbështetje të legjislacionit në fuqi, konkretisht:

- a) Ligjit Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.
- b) Ligjit Nr. 10296 dt.8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin,i ndryshuar.
- c) Ligjit Nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore",i ndryshuar.
- d) Ligjit Nr. 87/2025 “Për Buxhetin e vitit 2026”.
- e) Vendimin e KB Nr.113 datë 17.12.2025 “Për Buxhetin e Bashkisë Përmet viti 2026”,i ndryshuar.
- f) Ligjit Nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”.
- g) VKM-së Nr.414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”e ndryshuar.
- h) VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.
- i) VKB-së Nr.91 datë 22.10.2025 “Për miratimin e “Planit Vendor për Emergjencat Civile Bashkia Përmet 2025-2028”.
- j) Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Nr.6 datë 09.01.2026 “Për ngritjen e grupit të punës për konstatimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimi i ujrave dhe masive inertesh në Bashkinë Përmet”.
- k) Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Nr.14 datë 15.01.2026 “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimi i ujrave dhe masive inertesh në Bashkinë Përmet”.
- l) Shkresa Nr.429/6 Prot. datë 15.04.2026 e Ministrisë së Mbrojtjes,Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

2. Përmbledhje Ekzekutive

Ky projekt-vendim synon miratimin e përdorimit të fondit të emergjencave civile për përballimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore në territorin e Bashkisë Përmet. Nëpërmjet këtij akti propozohet mbështetja financiare për 8 (tetë) familje të prekura, në bazë të vlerësimeve të kryera nga grupet e punës së ngritura për këtë qëllim.

Qëllimi kryesor është ofrimi i ndihmës së menjëhershme dhe lehtësimit i pasojave ekonomike për familjet e dëmtuara, duke garantuar reagim institucional në përputhje me kuadrin ligjor për emergjencat civile.



3. Arsyetimi dhe nevoja për aktin

Gjatë periudhës së fundit, në territorin e Bashkisë Përmet janë evidentuar situata emergjente si pasojë e vërshimit të ujërave dhe depozitimit të masiveve inerte, të cilat kanë shkaktuar dëme në banesa dhe pasuri të qytetarëve.

Grupet e punës të ngritura me urdhër të Kryetarit të Bashkisë kanë kryer verifikimet në terren dhe kanë hartuar aktet përkatëse të konstatimit dhe vlerësimit të dëmeve, mbi bazën e të cilave rezulton nevoja për ndërhyrje financiare.

Mosmiratimi i këtij akti do të sillte pasoja sociale dhe ekonomike për familjet e prekura, duke rritur vështirësitë për përballimin e dëmeve dhe duke ulur efektivitetin e reagimit institucional në raste emergjencash.

4. Përputhshmëria me dokumentet strategjike

Ky projekt-vendim është në përputhje të plotë me:

- Planin Vendor për Emergjencat Civile 2025–2028 të Bashkisë Përmet;
- Buxhetin e miratuar të vitit 2026;
- Politikat kombëtare dhe vendore për menaxhimin e emergjencave civile dhe mbrojtjen e qytetarëve.

Ai kontribuon në realizimin e objektivave për rritjen e sigurisë dhe reagimit ndaj fatkeqësive natyrore.

5. Analiza Financiare dhe Buxhetore

Vlera totale e fondit të parashikuar për këtë qëllim është:

2 029 707 (dy milionë e njëzetë e nëntëmijë e shtatëqind e shtatë) lekë.

Ky fond do të përballohet nga zërat përkatës të buxhetit të Bashkisë Përmet për emergjencat civile, në përputhje me strukturën buxhetore të miratuar.

Ndikimi financiar është i përballueshëm dhe i planifikuar brenda kufijve të buxhetit vjetor, pa krijuar detyrime shtesë financiare.

Nr.	EMËR/MBIEMËR	VLERA TOTALE
1	ESAT HARKA	51 580.56
2	ARBEN ISUFI	644 154.34
3	XHEMAL CANO	663 519.79
4	THOMA ZHULATI	120 618.16
5	NAPOLON TICE	151 031.95
6	SOSE DHËMBI	51 352.34
7	YZEIR NIKOLLARI	117 027.59
8	VJOLLCA KUKURECI	230 422.27
	TOTALI	2 029 707



6. Konsultimi dhe përfshirja e palëve

Ky projekt-vendim bazohet në kërkesat e paraqitura nga qytetarët e dëmtuar dhe në verifikimet e kryera nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë.

Procesi i vlerësimit është realizuar nga ekspertë dhe grupe pune të specializuara, duke garantuar transparencë dhe objektivitet.

7. Konkluzione dhe Rekomandime

Në përfundim, vlerësohet se miratimi i këtij projekt-vendimi është i domosdoshëm dhe i justifikuar, pasi:

- a) adreson një situatë emergjente reale;
- b) mbështet drejtpërdrejt familjet e prekura;
- c) është në përputhje me kuadrin ligjor dhe financiar në fuqi.

Rekomandohet miratimi i projekt-vendimit nga Këshilli Bashkiak Përmet.

8. Dokumentet bashkëlidhur

- a) Kërkesat e qytetarëve;
- b) Foto të banesave, ku evidentohen problematikat;
- c) Proces-verbale konstatimi të dëmtimeve/gjendjes së banesave;
- d) Proces-verbale vlerësimi & Preventiv Punimesh;
- e) Kopje të dokumentit të pronësisë;

Duke ju falenderuar !

Konceptoi : **Bekim MEÇANI** (*Përgjegjës i Emergjencave Civile*)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ Prot.

Përmet, më _____.____.2026

P/VENDIM

Nr. ____ datë _____.____.2026

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR 26/2026 "PËR DISA SHTESA DHE NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR 69/2012 "PËR SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 5 "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak", pika ç, VKM Nr 127 datë 27.02.2026, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit Arsimor Parauniversitar" Ligji nr 26/2026 "Për disa shtesa dhe një ndryshim në ligjin nr 69/2012" Për sistemin arsimor parauniversitar ne Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 3, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

I. Të miratojë ndryshimet e përcaktuara në nenin 3 të ligjit nr 26/2026 që lidhen me njohjen e diplomës për personelin mësimdhënës/edukator.

II. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

III. Efektet financiare të këtij vendimi shtrihen prej datës 01.04.2026 .

**KRYETAR I BASHKISË
ALMA HOXHA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr. ___ datë ___ / ___ 2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR.124 DATË 17.12.2025 "PËR MIRATIMIN
E MENUVE DHE KUOTËS USHQIMORE, PËR OFRIMIN E VAKTEVE USHQIMORE NË
KUADËR TË PROJEKTIT «PËRQAFIMI I SHPRESËS NJË OAZ PËR ATA QË KANË
NEVOJË»**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr 9936, date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 68/2017 "Per financat e vetqeverisjes vendore", Ligjin Nr.115/2024"Për buxhetin e vitit 2025"; VKB Nr.79 datë 23.10.2024 "Për miratimin e Planit Social 2024-2027 për Bashkinë Përmet, Marrëveshjen Nr.72 Prot. datë 13.01.2024, midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Përmet, në zbatim të projektit «Përqaftimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë»; VKB Nr.124 datë 17.12.2025 "Për miratimin e menuve dhe kuotës ushqimore në kuadër të projektit "Përqaftimi i shpresës një oaz për ata që kanë nevojë", VKB Nr.16 datë 24.02.2026 "Për njohjen me buxhetin e alokuar nga Fondi Social per zbatimin e projektit "Përqaftimi i shpresës, për ata që kanë nevojë" viti 2026 dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Përmet", Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Kuota ushqimore mesatare javore për ofrimin e shërbimit një vakt ushqimor në kuadër të zbatimit të projektit "Përqaftimi i shpresës një oaz për ata që kanë nevojë" me çmimet e reja është në vlerën 215.36 lekë nga 240 lekë që ishte miratuar më parë pra me një efekt ulje 24.64 lekë.
2. Shpenzimet për blerjen e ushqimeve të përballohen nga buxheti i projektit dhe pjesa e bashkëfinancimit nga buxheti i bashkisë për vitin 2026.
3. Diferenca 24.64 lekë sipas cmimeve të reja do të zbritet nga secili bashkëfinancues aq % sa është zbritja nga fondi limit.
4. Efektet e zbatimit të këtij vendimi do të nisin që prej lidhjes së kontratave me secilin Operator Ekonomik për secilin lot.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori Juridik, Drejtoria e Buxhet-Financë, Drejtoria e Përfshirjes Sociale, Arsim-Kulturë, Sporte dhe Drejtoria e Projekteve.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË

ALMA HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

RELACION

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR.124 DATË 17.12.2025 "PËR MIRATIMIN
E MENUVE DHE KUOTËS USHQIMORE, PËR OFRIMIN E VAKTEVE USHQIMORE
NË KUADËR TË PROJEKTIT «PËRQAFIMI I SHPRESËS NJË OAZ PËR ATA QË
KANË NEVOJË»**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr 9936, date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 68/2017 "Per financat e vetqeverisjes vendore", Ligjin Nr.115/2024"Për buxhetin e vitit 2025"; VKB Nr.79 datë 23.10.2024 "Për miratimin e Planit Social 2024-2027 për Bashkinë Përmet, Marrëveshjen Nr.72 Prot datë 13.01.2024, midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Përmet, në zbatim të projektit «Përqaftimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë»,VKB Nr.124 datë 17.12.2025 "Për miratimin e menuve dhe kuotës ushqimore në kuadër të projektit "Përqaftimi i shpresës një oaz për ata që kanë nevojë", VKB Nr.16 datë 24.02.2026 "Për njohjen me buxhetin e alokuar nga Fondi Social per zbatimin e projektit "Përqaftimi i shpresës, për ata që kanë nevojë" viti 2026 dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Përmet";

Në mbështetje të ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar neni 36, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar,VKM-në Nr.531 datë 7.9.2023 "Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sha, për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë i ndryshuar me VKM-në Nr. 504, datë 10.9.2025; VKM-në nr.768, datë 13.12.2024 dhe VKM-në nr.67, datë 29.1.2025 neni 13/4 Procedura e prokurimit me objekt: Blerje ushqime për ofrimin e vakteve ushqimore në kuadër të zbatimit të projektit "Përqaftimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë" i financuar për vitin 2026 nga Fondi Social dhe bashkëfinancim të Bashkisë Përmet, nisi në muajin Janar ku Bashkia Përmet ju drejtua Operatorit të Blerjeve të Përqendruara me shkresë Nr.4354 prot date 31.12.2025 për kryerjen e shërbimit të prokurimit.

Procedura realizohet nga OBP duke ju referuar kuotës dhe produkteve të kërkuara sipas menuve të miratuara dhe ky proces finalizohet me shpalljen e operatorëve fitues dhe lidhjen e Kontratave konkretisht:

- Loti I: Kontrata Nr.1223 datë 01.04.2026 midis Bashkisë Përmet dhe operatorit Ekonomik 4 S shpk për "Blerje Bukë gruri dhe simite".
- Loti II: Kontrata Nr.1225 datë 01.04.2026 midis Bashkisë Përmet dhe operatorit Ekonomik Sinani Trading shpk për "Blerje Bulmet dhe produktet e tij".
- Loti III: Kontrata Nr.1224 datë 01.04.2026 midis Bashkisë Përmet dhe operatorit Ekonomik 4S shpk për "Blerje Vezë" .

- Loti IV: Kontrata Nr.1221 datë 01.04.2026 midis Bashkisë Përmet dhe operatorit Ekonomik Kaza-Meat shpk për “Blerje Mish i kuq dhe produktet e tij”.
- Loti V: Kontrata Nr.1227 datë 01.04.2026 midis Bashkisë Përmet dhe operatorit Ekonomik MC-Catering shpk për “Blerje Mish Pule”.
- Loti VI: Kontrata Nr.1226 datë 01.04.2026 midis Bashkisë Përmet dhe operatorit Ekonomik MC-Catering shpk për “Blerje Ushqime Koloniale”.
- Loti VII: Kontrata Nr.1222 datë 01.04.2026 midis Bashkisë Përmet dhe operatorit Ekonomik 4S shpk për “Blerje Fruta -Perime”.

Referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.124 datë 17.12.2025 “Për miratimin e menuve dhe kuotës ushqimore për ofrimin e vakteve ushqimore në kuadër të projektit “Përqaqimi i shpresës një oaz për ata që kanë nevojë”, kuota mesatare javore (5 ditë nga e hëna –të premte) ishte 240 lekë/person me TVSH.

Procedura e prokurimit është realizuar për një periudhë 49 javë dhe totali javor referuar kontratave me operatorët fitues është **44 865.9** lekë me TVSH. Numri i përfituesve është 50 sipas listës së miratuar me VKB Nr.123 datë 17.12.2025. Pra kuota mesatare javore sipas vlerave të kontratave të operatorëve fitues dhe cmimeve të ofruara prej tyre është mesatarisht **215.36** lekë/person me TVSH.

Referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.16 datë 24.02.2026 “Për njohjen me buxhetin e alokuar nga Fondi Social për zbatimin e projektit “Përqaqimi i shpresës, për ata që kanë nevojë” viti 2026 dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Përmet”, blerja e produkteve ushqimore për ofrimin e shërbimit “një vakt ushqimor” ka një buxhet prej 1 562 870 lekë me TVSH nga Fondi Social dhe 1 377 130 lekë me TVSH bashkëfinancim i Bashkisë Përmet.

Pas përfundimit të procedurës së prokurimit, diferenca nga fondi limit është 301 790 lekë (ose afërsisht 10.27%). Kjo diferencë, pas komunikimit edhe me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të zbritet aq % sa është diferenca nga fondi limit për secilin financues. Pra, financimi i Fondit Social për këto Kontrata do të jetë: **1 403 466.54** lekë me TVSH dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Përmet për këto Kontrata do të jetë në vlerën **1 234 628.46** lekë me TVSH.

Kuota ushqimore mesatare javore për ofrimin e shërbimit një vakt ushqimor në kuadër të zbatimit të projektit “Përqaqimi i shpresës një oaz për ata që kanë nevojë me çmimet reja është në vlerën 215.36 lekë nga 240 lekë që ishte miratuar më parë pra me një efekt ulje 24.64 lekë.

Drejtorja e Përfshirjes Sociale, Arsim-Kulturë, Sporte

Arjana Papapano





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr. ____ datë ____ / ____ 2026

PËR
DETAJIMIN E ZËRAVE TË SHPENZIMEVE PËR AKTIVITETIN KULTUROR
AKTIVITETI «FESTIVALI VJOSA ART (VJOSART INTERNATIONAL)» DHE
AKTIVITETI «FESTIVALI NONA-FESTA E GJYSHEVE SHQIPTARE»

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, Ligjin Nr 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin Nr. 68/2017 “Per financat e vetqeverisjes vendore”, Ligjin Nr.115/2024“Për buxhetin e vitit 2026”, VKB Nr.113 datë 17.12.2025 “Për buxhetin e Bashkisë Përmet për vitin 2026” i ndryshuar , VKB Nr.86 datë 05.11.2024 «Për krijimin e Këshillit artistiko-kulturor pranë Bashkisë Përmet»; Kërkesa dhe Projekti «Festivali Vjosa Art (Viosart International)» «Festivali NONA-Festa e Gjysheve Shqiptare» Nr. 1049 Prot datë 13.03.2026 nga «Shoqata Albania S’ka Problem»; Vendim i Këshillit artistiko-kulturor Nr.1379 Prot datë 10.04.2026; Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

- Miratimin e zërit shpenzim për aktivitetin kulturor:
 - ” Festivali Vjosa Art (Vjosart International) me shumën 300.000 (treqind mijë) lekë
 - “ Festivali Nona -Festa e Gjysheve Shqiptare” në shumën 300 000 (dyqind mijë) lekë.
- Shpenzimet e aktiviteteve do të mbulohen nga buxheti i vitit 2026 parashikuar nga strukturat buxhetore:
 - AD135.01 V822AAD KAP 01 vlera 570 000 lekë
 - AD135.05.V822AAD .KAP 05 vlera 30 000 lekë
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përfshirjes Sociale, Arsimit-Kulturë, Sporte, Drejtoria e Projekteve dhe Drejtoria e Buxhetit Financë.
- Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit në Prefekturë.

KRYETAR I BASHKISË

ALMA HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

RELACION

PËR

DETAJIMIN E ZËRAVE TË SHPENZIMEVE PËR AKTIVITETIN KULTUROR

«FESTIVALI VJOSA ART (VJOSART INTERNATIONAL)» DHE

«FESTIVALI NONA - FESTA E GJYSHEVE SHQIPTARE»

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë“, Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin“, Ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore“, Ligjin Nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2026“, VKB Nr.113 datë 17.12.2025 “Për buxhetin e Bashkisë Përmet për vitin 2026” i ndryshuar, si dhe Vendimin e Këshillit artistiko-kulturor Nr.1379 Prot datë 10.04.2026;

Shoqata “Albania S’ka Problem” paraqiti kërkesën dhe projektet «Festivali Vjosa Art (Viosart International)» dhe «Festivali NONA - Festa e Gjysheve Shqiptare» me Nr. 1049 Prot datë 13.03.2026. Shoqata “Albania S’ka Problem” ka paraqitur një kalendar të gjerë aktiviteteve kulturore dhe artistike për vitin 2026 në Bashkinë Përmet, duke marrë përsipër realizimin e pjesës më të madhe të tyre nëpërmjet sigurimit të fondeve nga sponsorë dhe bashkëpunime të ndryshme. Në këtë kuadër, mbështetja financiare e kërkuar nga Bashkia Përmet është përqendruar vetëm në dy prej aktiviteteve kryesore, konkretisht «Festivali Vjosa Art (Viosart International)» dhe «Festivali NONA - Festa e Gjysheve Shqiptare», të cilat konsiderohen me impakt të drejtpërdrejtë në promovimin e turizmit dhe gjallërimin e jetës kulturore në qytet.

Shoqata e sipërpërmendur është një ndër organizatat më aktive në jetën kulturore të qytetit të Përmetit, duke organizuar çdo vit evente të rëndësishme që sjellin gjallëri në qytet, rrisin pjesëmarrjen e komunitetit dhe ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e turizmit dhe ekonomisë lokale.

1. «Festivali Vjosa Art (Viosart International)»



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

(23–24 maj 2026) Festivali “Vjosa Art” është një event artistik me karakter ndërkombëtar, i cili zhvillohet përgjatë lumit Vjosa dhe ndërthur artin, muzikën dhe natyrën në një platformë të përbashkët kulturore. Ky festival parashikon: pjesëmarrjen e artistëve vendas dhe të huaj (piktorë, skulptorë, performerë) koncerte live me këngëtarë të njohur të muzikës shqiptare performanca artistike dhe aktivitete kreative në natyrë instalacione arti dhe ekspozita të hapura për publikun aktivitete rinore dhe ndërveprim me komunitetin mbulim mediatik nga televizione dhe platforma kombëtare. Në boshtin e këtij aktiviteti qëndron promovimi i lumit Vjosa si një nga pasuritë më të rëndësishme natyrore të vendit, duke e kthyer atë në një destinacion të artit dhe turizmit alternativ. Ky festival pritet të tërheqë një numër të konsiderueshëm vizitorësh, artistësh dhe turistësh, duke e vendosur Përmetin në hartën e eventeve kulturore me impakt të gjerë.

2. «Festivali NONA - Festa e Gjysheve Shqiptare»

(7–8–9 gusht 2026) Festivali NONA është një aktivitet i konsoliduar që i kushtohet figurës së gjyshes shqiptare, duke promovuar vlerat familjare, traditat dhe kulturën vendase.

Ky festival përfshin: koncerte me këngëtarë të njohur të muzikës shqiptare panair të produkteve tradicionale dhe kulinarisë ekspozita dhe aktivitete artizanale aktivitete sociale dhe kulturore për komunitetin pjesëmarrje të gjerë të qytetarëve, turistëve dhe emigrantëve. Ky event zhvillohet në kulmin e sezonit turistik dhe është kthyer ndër aktivitetet më të dashura për qytetin, duke sjellë një atmosferë festive dhe një impakt të drejtpërdrejtë në jetën ekonomike dhe sociale.

QËLLIMI I ORGANIZIMIT TË AKTIVITETEVE

- Organizimi i këtyre eventeve ka qëllim të trefishtë:
- Promovimin e vlerave turistike dhe kulturore të qytetit të Përmetit
- Argëtimin dhe përfshirjen e komunitetit (qytetarë, turistë, emigrantë)
- Zhvillimin ekonomik për bizneset lokale

IMPAKTI

Nga realizimi i këtyre aktiviteteve:

- pritet të përfitojnë mijëra artdashës dhe vizitorë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

- rritet fluksi i turistëve në qytet
- përfitojnë bizneset lokale (akomodim, gastronomi, shërbime)
- rritet promovimi i Përmetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar
- forcohet identiteti kulturor dhe përfshirja komunitare

KOSTO E FINANCIMIT

Kosto e financimit për këto aktivitete është si më poshtë:

Për aktivitetin “Festivali Vjosa Art (Viosart International)” në shumën 300,000 (treqind mijë) lekë

Për aktivitetin “Festivali NONA - Festa e Gjysheve Shqiptare” në shumën 300,000 (treqind mijë) lekë

Shpenzimet e aktiviteteve do të mbulohen nga buxheti i vitit 2026 i parashikuar nga strukturat buxhetore:

AD135.01 V822AAD KAP 01 në vlerën 570,000 lekë

AD135.05.V822AAD KAP 05 në vlerën 30,000 lekë

Bashkëngjitur kërkesa dhe projektet përkatëse të paraqitura nga Shoqata “Albania S’ka Problem”.

Drejtoria e Përfshirjes Sociale, Arsim-Kulturë, Sporte

Arjana PAPAPANO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr. _____ dt _____ / _____ /2026.

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES DHE TARIFAVE E PËRDORIMIT DHE
DHËNIEN ME QIRA TË BIÇIKLETAVE ELEKTRIKE NË MBËSHTETJE TË
TURIZMIT, BASHKIA PËRMET**

Këshilli Bashkiak Përmet i mbledhur më datën: ____ / ____ / 2026, në mbështetje të Në mbështetje të: Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendim nr.153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Akteve nënligjore në fuqi për sigurinë rrugore dhe transportin, Ligj nr 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, Ligj nr 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, Marrëveshjes së bashkëpunimit nr 1785/1 datë 13.06.2025 midis Bashkisë Përmet dhe FSHZH në kuadër të projektit “Pajisje për mbështetjen e shërbimeve bashkiake për përmirësimin e menaxhimit të trafikut”, Akt dorëzimit nr. 2228 datë: 09.07.2025 të 25 (njëzet e pesë) cop biçikleta elektrike (*bicycle+charger*) sipas dokumentacionit shoqërues të tyre , pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga komisioni Drejtoria Juridike, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Buqësisë, Turizmit, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, dhe me propozim të Kryetari të Bashkisë

VENDOSI:

- 1- Të miratojë rregulloren dhe tarifat për funksionimin e biçikletave elektrike në Bashkinë Përmet sipas dokumentit bashkëlidhur dhe është pjesë përbërëse e tij.
- 2- Të miratojë kontratën e përdorimit tip për dhënie me qira të biçikletave elektrike në Bashkinë Përmet sipas Aneksit 1 bashkëlidhur rregullores dhe është pjesë përbërëse e tij.
- 3- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Buqësisë, Turizmit, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Sektori i aktiviteteve kinema-muze, Zyra e financës në Bashki.
- 4- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I BASHKISË

Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PËRMET

DREJTORIA JURIDIKE

DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, BUJQËSISË, DHE TURIZMIT

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

RELACION

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES DHE TARIFAVE E PËRDORIMIT DHE
DHËNIEN ME QIRA TË BIÇIKLETAVE ELEKTRIKE NË MBËSHTETJE TË
TURIZMIT, BASHKIA PËRMET.**

Të nderuar Këshilltarë.

Informacion i përgjithshëm rreth biçikletave elektrike (*bicycle+charger*).

Bashkia Përmet në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit nr 1785/1 datë 13.06.2025 midis Bashkisë Përmet dhe FSHZH në kuadër të projektit “Pajisje për mbështetjen e shërbimeve bashkiake për përmirësimin e menaxhimit të trafikut”, ka përfituar 25 (*njëzet e pesë*) cop biçikleta elektrike (*bicycle+charger*) të shoqëruara me dokumentacion e të dhënave dhe katalogut shoqërues.

Përdorimi i biçikletës konsiderohet si një aktivitet fizik i moderuar, i dobishëm njëherësh si për shëndetin, ashtu edhe për mjedisin. Përdorimi i biçikletës është një nga mënyrat më të thjeshta, më të lira dhe më të shëndetshme për të lëvizur nga një vend në tjetrin. Në një kohë kur trafiku, ndotja dhe stili i jetës sedentare janë kthyer në probleme të përditshme, biçikleta ofron një zgjidhje praktike dhe të gjithanshme.

Me qëllim vënien në funksion të tyre në mbështetje të turizmit si një mjet transporti që kombinon përfitimet e biçikletës tradicionale me mbështetjen e një motori elektrik, duke e bërë lëvizjen më të lehtë dhe më të përshtatshme për distanca më të gjata apo terrene me pjerrësi, por sidomos promovimin e levizjes green për kategorinë e turistëve vëndas dhe të huaj të cilët vizitojnë Qytetin e Përmetit, është e nevojshme hartimi dhe miratimi i rregullores për mënyrën e operimit dhe funksionimit të këtij shërbimi si dhe tarifat për përdorimin e tyre.

1. Qëllimi i projekt-vendimit

Qëllimi i këtij projekt-vendimi është krijimi i një kuadri rregullator për funksionimin e shërbimit dhe dhënie me qira të biçikletave elektrike në territorin e Bashkisë Përmet, duke promovuar forma alternative, mbështetjen e turizmit dhe të qëndrueshmërisë së transportit urban.

Ky shërbim synon:

- përmirësimin e mobilitetit urban;
- reduktimin e trafikut dhe ndotjes së ajrit;
- promovimin e transportit ekologjik;
- zhvillimin e turizmit dhe përdorimin e hapësirave publike në mënyrë më efikase.

2. Baza ligjore

Projekt-vendimi mbështetet në:

Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i cili i jep bashkisë kompetencë për Menaxhimin e transportit lokal dhe hapësirave publike;

Ligji Nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” dhe akteve në zbatim të tij, Legjislacionin për transportin rrugor dhe rregullat e qarkullimit;

Politikat kombëtare dhe europiane për transport të qëndrueshëm dhe mobilitet urban.

Vendimi nr.157, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, përcakton rregulla të përdorimit të mjeteve të ndryshme të transportit rrugor, përfshi edhe lëvizjen me biçikleta elektrike.

Ligj nr 68/2017 “Për Financat e Vetqeverisjes Vendore” i ndryshuar, Ligj nr 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, përcakton vendosjen e tarifave për përdorimin e shërbimit, të ardhurat dhe shpenzimet që do krijohen nga ky shërbim.

Marrëveshja e bashkëpunimit nr 1785/1 datë 13.06.2025 midis Bashkisë Përmet dhe FSHZH në kuadër të projektit “Pajisje për mbështetjen e shërbimeve bashkiake për përmirësimin e menaxhimit të trafikut”, Akt dorëzimit nr. 2228 datë: 09.07.2025 të 25 (njëzet e pesë) cop biçikleta elektrike (*bicycle+charger*) sipas dokumentacionit shoqërues të tyre

3. Përmbajtja e projekt-vendimit

Projekt-vendimi parashikon:

- Miratimin e një rregulloreje për përdorimin dhe funksionimin e biçikletave elektrike; përcaktimin e rregullave për përdoruesit vëndas dhe të huaj;
- Kontratën e përdorimit (dhënies me qira) të këtyre biçikletave elektrike
- Vendosjen e tarifave për përdorimin dhe ofrimin e shërbimit;
- Përcaktimin e autoriteteve përgjegjëse për kontrollin dhe monitorimin e aktivitetit.

4. Përfitimet nga zbatimi

Zbatimi i kësaj rregulloreje pritet të sjellë:

- Mbështetjen e turizmit dhe të qëndrueshmërisë së transportit urban.
- rritjen e përdorimit të mjeteve alternative të transportit;
- uljen e emetimeve ndotëse në qytet;
- përmirësimin e cilësisë së jetës për qytetarët;
- krijimin e një shërbimi të ri urban për banorët dhe turistët.

5. Efektet financiare

- Tarifat e përcaktuara në këtë projekt-vendim nga ofrimi i këtij shërbimi krijojnë të ardhura për buxhetin e bashkisë nga:

- tarifat e përdorimit të biçikletave; (tabela 1)

- Të ardhurat e mundshme janë parashikuar sipas Skenari mesatar (për 60% përdorim) menaxhimit të shërbimit. (tabela 2)

- Shpenzimet e parashikuara sipas Skenarit mesatar (60% përdorim) tabela 3

tabela 1

Nr	Koha e përdorimit	Çmimi mesatar Lek	Përshkrimi
1	0 - 1 orë	200	Ideale për xhiro të shpejta
2	0 - 2 orë	300	Për lëvizje të shpejtë në qytet
3	2 - 4 orë	500	Shëtitje e shkurtër turistike
4	4 - 6 orë	800	Vizitë në disa pika turistike
5	6 - 8 ore	1,000	Gjysmë dite eksplorim
6	8- 12 orë	1,500	Paketë turistike
7	24 orë	2,000	Eksplorim më i gjatë turistik
8	3 ditë	3,000	Paketë turistike e plote

tabela 2

Te ardhurat e mundshme. Skenari mesatar (60% përdorim)

Nr	Nr total e-bike	perdorimi mes. Ditor	Nr e-bike mund te perdoren ne dite (b x c)	shfrytezimi mes 180 dite (Prill-Shtator)	cmimi mes/dite/bike	te ardhura mes ditore (d x f)	te ardhura mes vjetore (e x g)
a	b	c	d	e	f	g	h
biciklete elektrike (e-bike)	25	60%	15	150	1,163	17,445	2,616,750

Tabela 3

Shpenzimet sipas Skenarit mesatar (60% perdorim)						
Emertimi	Nr	Cmim/njesi	Nr e-bike	Shpz mes/dit	total dite (Prill-Shtator)	Shuma
Mirëmbajtje 30%	25	349	15	5,235	180	942,300
Energji / karikim 5%	25	100	15	1,500	180	270,000
Punonjës (2 person)	816,900	-	-	-	-	816,900
Totali						2,029,200

Te ardhura	2,616,750
Shpenzime	2,029,200
Dif neto/fitim	587,550

6. Përfundime

Në përfundim, propozohet që Këshilli Bashkiak të miratojë projekt-vendimin "Për miratimin e rregullore dhe tarifave për funksionimin e shërbimit të biçikletave elektrike në territorin e Bashkisë Përmet" si dhe kontratën tip të përdorimit Aneksi 1 sipas dokumentit bashkëlidhur dhe është pjesë përbërëse e tij.

Bashkëlidhur këtij Projekt-Vendimi: Autorizim prodhuesi, Çertifikatë, Katalogun me të dhënat për këto biçikleta, Shkresa nr 3492/1 datë 05.03.2026 e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor në lidhje me qarkullimin e këtyre mjeteve.

Kjo rregullore u hartua në bashkëpunim me ekspertët e kontraktuar nga FSHZH.

Duke ju falenderuar.

Adminstrator i Shërbimeve Publike: Arian JAUPI

Zyra Juridike, Juristi: Enea KUSHE

Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit: Etleva MYFTARI

KRYETARI I BASHKISË

Alma HOXHA



BASHKIA PËRMET

PROJEKT VENDIM

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KUSHTET DHE RREGULLAT E ZËNIES SË HAPËSIRËS PUBLIKE NË BASHKINË PËRMET”

Në mbështetje të nenit 8, pika 1, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “a”, nenit 23, pika 14, nenit 33, pika 1, shkronja “ç”, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6 dhe nenit 64, shkronja “c” të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 9 pika 4 të VKM nr. 224, datë 1.4.2026 “Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike”; të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 4/1 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin territorit”, i ndryshuar; nenit 15, pika 3 të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligj Nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake” (i ndryshuar); nenit 7, nenit 8, nenit 9 dhe nenit 11 të VKM nr. 224, datë 1.4.2026 “Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike”, me qëllim përdorim të uniformuar të hapësirës publike në Bashkinë Permet dhe krijimin e një mjedisi urban të rregullt dhe funksional në shërbim të komunitetit me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për kushtet dhe rregullat e zënies së hapësirës publike në Bashkinë Permet”, sipas tekstit bashkëlidhur dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Çdo leje për zënie e hapësirës publike në Bashkinë Permet e lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi të Këshillit Bashkiak, mbetet në fuqi sipas afatit dhe kushteve të përcaktuara në momentin e lëshimit, për atë kohë sa nuk bien ndesh me këtë vendim.
3. Strukturat e përkohshme/kioskat të vendosura në hapësirën publike të Bashkisë Përmet detyrohen që brenda një periudhe kohore prej 1 viti, të pajisen me lejen për ushtrimin e aktivitetit dhe të nënshkruajnë marrëveshjet përkatëse, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë vendim.
4. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Permet dhe të gjitha strukturat përgjegjëse për menaxhimin e hapësirave publike dhe drejtoritë e vartësisë së Bashkisë Permet për zbatimin e kësaj rregullore. për miratimin e hartës së hapësirave publike pas konsultimit publik, Formave, materialet dhe ngjyrat e pajisjeve të lejuara, vëndet e organizimit të tregjeve të përkohshme, strukturat e përkohshme të lëvizshme, formularëve të aplikimit dhe formatit të lejeve për kushtet dhe rregullat e zënies së hapësirës publike në Bashkinë Përmet, për secilën prej kategorive të lejes në përputhje me rregulloren pjesë përbërëse e këtij vendimi.
6. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Përmet nr. 23 datë 31.03.2022 “Për kushtet dhe rregullat e zënies së hapësirës publike në Bashkinë Permet” shfuqizohet
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastr.

KRYETARI I BASHKISË

Alma HOXHA





BASHKIA PËRMET
DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK BUQËSISË DHE TURIZMIT
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ZYRA JURIDIKE



RELACION

Drejtuar: KËSHILLIT TË BASHKISË PËRMET

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KUSHTET DHE RREGULLAT E ZËNIES SË
HAPËSIRËS PUBLIKE NË BASHKINË PERMET

Të nderuar

Në mbështetje të nenit 8, pika 1, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “a”, nenit 23, pika 14, nenit 33, pika 1, shkronja “ç”, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6 dhe nenit 64, shkronja “c” të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 9 pika 4 të VKM nr. 224, datë 1.4.2026 “Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike”; të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 4/1 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin territorit”, i ndryshuar; nenit 15, pika 3 të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligj Nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, i ndryshuar; nenit 7, nenit 8, nenit 9 dhe nenit 11 të VKM nr. 224, datë 1.4.2026 “Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike”, me qëllim përdorim të uniformuar të hapësirës publike në Bashkinë Permet dhe krijimin e një mjedisi urban të rregullt dhe funksional në shërbim të komunitetit hartohet ky relacion drejtuar Këshillit Bashkisë Përmet.

I. HYRJE DHE KONEKSTI

Në zbatim të VKM Nr 224 date 01.04.2026 si dhe në kuadër të ushtrimit të funksioneve të njësisë së vetëqeverisjes vendore për administrimin e territorit dhe pasurive publike, në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës në komunitet, paraqitet për shqyrtim dhe miratim projekt-rregullorja “Për shfrytëzimin e hapësirës publike”.

Zhvillimi i shpejtë urban, rritja e numrit të turistëve sidomos në sezonin veror, rritja e aktiviteteve tregtare dhe shërbimeve, si dhe kërkesa në rritje për përdorimin e hapësirave publike (trotare, sheshe, zona rekreative, etj.) kanë nxjerrë në pah nevojën për një kuadër të ri e të qartë rregullator, i cili të sigurojë balancën midis interesit publik dhe aktivitetit privat.

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat, kushtet e procedurat për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike në Bashkinë Përmet dhe krijimin e një mjedisi urban të rregullt dhe funksional në shërbim të komunitetit. Në zbatim të VKM Nr 224 date 01.04.2026, si dhe në kuadër të përmirësimit të menaxhimit të hapësirave publike dhe garantimit të një përdorimi të drejtë, të rregullt dhe transparent të tyre, paraqitet për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit të Bashkisë projekt-rregullorja “Për shfrytëzimin e hapësirës publike në qytetin e Përmetit”.

Kjo rregullore bën të mundur në zbatim të: ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin territorit”, i ndryshuar, VKM Nr 224 date 01.04.2026, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006,“

Për sistemin e taksave vendore“, i ndryshuar, për sa i përket mënyrës së organizimit dhe kompetencave të administratës së Bashkisë, administrimit dhe menaxhimit të hapësirave publike, duke synuar efektivitetin dhe menaxhimin sa më të mirë dhe transparent të kësaj rregulloreje gjatë implementimit të saj.

Kjo rregullore është hartuar në zbatim të VKM Nr 224 date 01.04.2026 si dhe në kuadër të përmirësimit të shfrytëzimit të hapësirave publike nga individë apo subjekte që operojnë në fushën e shërbimeve tregëtare, bar-restorante, tregëti ambulante, reklama, konkretisht të marrëdhënies juridike së detyrueshme midis aktivitetit privat dhe pronave publike, nisur edhe nga problematikat që janë hasur me pare gjatë shfrytëzimit të hapësirave publike.

Njëkohësisht, kjo rregullore bën pjesë të fokusit të saj, aktivitetet e lejuara subjekte apo individë që kërkojnë të shfrytëzojnë hapësirat publike të panjohura me pare, si për shembull kush ka të drejtë të shfrytëzojë hapësirat publike, rregullat që duhet të zbatohen gjatë shfrytëzimit të saj, të drejtat dhe detyrimet që kanë përfituesit për këto hapësira, dokumentacioni ligjor që duhet të kenë në momentin e aplikimit etj. Në këtë rregullore, do të shmangen problematikat që janë hasur me pare, për të unifikuar rregullat, procedurën, detyrimet, dokumentacionin e nevojshëm për shfrytëzimin e hapësirës publike.

Objektivat që synohen të arrihen nepermjet kësaj rregullore, kanë të bëjnë me: (i) administrimin dhe funksionimin sa më të mirë të hapësirave publike, (ii) unifikimi i rregullave të shfrytëzimit të hapësirave publike, (iii) të drejtat dhe detyrimet që kanë përfituesit për shfrytëzimin e hapësirave publike, (iv) procedura dhe dokumentacioni që duhet për shfrytëzimin e hapësirave publike, (v) aktivitetet e lejuara në hapësirën publike.

II. QËLLIMI I RREGULLORES

Qëllimi i kësaj rregulloreje është:

- Të përcaktojë rregullat dhe procedurat për përdorimin e hapësirave publike;
- Të garantojë akses të barabartë për të gjithë subjektet e interesuara;
- Të mbrojë interesin publik, mjedisin dhe estetikën urbane;
- Të parandalojë abuzimet dhe përdorimin e paligjshëm të hapësirave publike.
- Të vendosë rregulla të qarta, transparente dhe të zbatueshme për përdorimin e hapësirave publike;
- Të garantojë përdorim të drejtë dhe të barabartë për subjektet fizike dhe juridike;
- Të ruajë estetikën urbane dhe funksionalitetin e hapësirave publike;
- Të formalizojë dhe monitorojë aktivitetet ekonomike që zhvillohen në këto hapësira.

III. BAZA LIGJORE

Kjo rregullore mbështetet në:

- Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- VKM nr. 224, datë 1.4.2026 “Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike” neni 7, neni 9, neni 126 dhe vijues.
- Ligj Nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake” (i ndryshuar)
- Legjislacionin në fuqi për menaxhimin e pronës publike;
- Aktet nënligjore dhe vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave.

IV. PËRMBAJTJA KRYESORE E RREGULLORES

Rregullorja parashikon:

- Llojet e hapësirave publike që mund të jepen në përdorim;
- Procedurat e aplikimit dhe kriteret e përzgjedhjes;
- Afatet dhe kushtet e përdorimit;
- Tarifat përkatëse dhe mënyrën e pagesës;

- Detyrimet dhe përgjegjësitë e përdoruesve;
- Masat administrative në rast shkeljesh.

1. Kategoritë e hapësirave publike

- Përcaktuare dhe rrugë këmbësorësh;
- Sheshe dhe hapësira publike urbane;
- Parqe dhe zona rekreative;
- Hapësira pranë objekteve publike;
- Zona të përcaktuara për aktivitete tregtare apo kulturore.

2. Llojet e përdorimit

- Vendosja e tavolinave dhe karrigeve nga subjektet e shërbimit;
- Instalimi i strukturave të përkohshme (kioska, stenda, reklama);
- Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive dhe promocionale;
- Përdorimi për qëllime ndërtimi të përkohshëm (skela, depozitime).

V. ARSYETIMI

Miratimi i kësaj rregulloreje është i domosdoshëm për:

- Zbatimi i VKM Nr 224 datë 01.04.2026 “Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike” si dhe kuadri ligjor sectorial.
- Rritjen e transparencës dhe efikasitetit në administrimin e hapësirave publike;
- Përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet;
- Mbështetjen e aktiviteteve ekonomike në mënyrë të kontrolluar;
- Ruajtjen e rendit dhe pastërtisë në territorin e bashkisë.

VI. NDIKIMI FINANCIAR

Zbatimi i rregullores pritet të ketë ndikim pozitiv në të ardhurat e bashkisë përmes tarifave të përcaktuara për përdorimin e hapësirës publike, si dhe të reduktojë kostot që lidhen me menaxhimin informal të tyre.

VII. KONKLuzioni

Në përfundim, propozohet që Këshilli i Bashkisë të shqyrtojë dhe të miratojë rregulloren “Për shfrytëzimin e hapësirës publike”, si një instrument i domosdoshëm për menaxhimin e qëndrueshëm dhe të drejtë të hapësirave publike.

PËRMBLEDHJE E SHKURTUAR E PËRMBAJTJES SË DRAFT-RREGULLORES

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Objekti dhe qëllimi

- Përcaktimin e rregullave, kushteve, kritereve dhe procedurave të detajuara për shfrytëzimin e hapësirave publike në territorin e Bashkisë Përmet.
- Garantimi i një përdorimi të rregullt funksional dhe të qëndrueshëm të hapësirës publike,
- Përgjegjësitë e Bashkisë Përmet, institucioneve publike si dhe përdoruesve të hapësirës publike
- barazinë e trajtimit dhe paaësinë në procesin e shqyrtimit, dhënies së lejeve

Parimet për shfrytëzimin e hapësirës publike

- Parimi i prevalimit të interesit publik ndaj atij privat
- Parimi i aksesit të lirë dhe të barabartë
- Parimi i mbrojtjes së mjedisit dhe identitetit urban
- Parimi i transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe paaësia në procedurat e dhënies së lejeve për shfrytëzimin e hapësirave publike.

Përkufizime

- Në nenin 4 të rregullores janë përcaktuar termat e kuptimeve për aktivitetet e lejuara si dhe kuptimin e elementeve perberës të hapësirës publike.

Kushtet e përgjithshme të shfrytëzimit të hapësirave publike

- Shfrytëzimi i hapësirave publike bëhet vetëm me leje të lëshuar nga Bashkia ose institucionet publike qendrore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Aksesit i publikut në hapësirat publike, përfshirë zonat me prioritet zhvillimin e turizmit, nuk mund të kufizohet ose të ndalohet në asnjë formë nga subjektet që disponojnë leje për shfrytëzimin e tyre.
- Detyrimet e Subjekteve të cilët janë pajisur me leje për shfrytëzimin e hapësirës publike

KREU II STRUKTURAT ZBATUESE DHE MONITORUESE

- **Përgjegjësitë e Bashkisë.** Bashkia është organi përgjegjës për dhënien e lejeve për shfrytëzimin e hapësirave publike, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë rregullore dhe legjislacionin sektorial në fuqi
- **Roli i kryetarit të bashkisë.** Kryetari i Bashkisë miraton lejet për shfrytëzimin e hapësirës publike me afat deri në 1 (një) vit, në zbatim të vendimeve dhe tarifave të miratuara nga këshilli bashkiak, bazuar në raportet e hartuara nga struktura përgjegjëse për shqyrtimin e aplikimeve në bashki. Kryetari ka kompetencë të pezullojë ose të revokojë lejet e shfrytëzimit të hapësirave publike në rast shkeljesh të kushteve të përcaktuara në këtë rregullore, mbi bazën e proces-verbaleve ose raporteve të hartuara nga strukturat përgjegjëse.
- **Përgjegjësitë e Këshillit Bashkiak.** Këshilli Bashkiak miraton tarifat e zënies së hapësirave publike. Këshilli Bashkiak mund të miratojë leje për shfrytëzimin e hapësirave publike për një periudhë deri në 5 (pesë) vjet
- **Strukturat përgjegjëse për kontrollin e hapësirës publike në bashki.** Struktura përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Shërbimet publike. Sektori i pastrim- gjelbërimit. Taksat dhe tarifat vendore. Struktura përgjegjëse për çështjet juridike, asetet dhe/ose licencimin. Këto struktura raportojnë periodikisht te kryetari i bashkisë dhe informojnë këshillin bashkiak mbi aktivitetin dhe problematikat në menaxhimin e hapësirave publike

KREU III SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR AKTIVITETE GASTRONOMIKE (BAR, RESTORANTE, HOTELERI DHE SHËRBIME TË NGJASHME) DHE REKREATIVE

- **Aktivitetet e lejuara.** Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat përcaktohen në lejen për hapësirën publike ku synohet ruajtja e një estetike urbane uniforme, format, materialet dhe ngjyrat e pajisjeve përcaktohen nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit vendosjen e tavolinave, karrigeve, menuve dhe çadrave të lëvizshme për ofrimin e shërbimeve gastronomike (bare, restorante, kafene, hotele dhe aktivitete të ngjashme), vendosjen e pajisjeve të lëvizshme të lojërave për fëmijë, të cilat duhet të jenë të përshtatshme për moshën, të certifikuara sipas standardeve në fuqi,
- **Ndalohen në mënyrë kategorike:**
 - a) vendosja e barrierave erëpritëse, vazove ose elementeve të tjera që krijojnë barriera fizike për lëvizjen e lirë të qytetarëve;
 - b) vendosja e pedanave dhe tapeteve mbi hapësirat publike të gjelbëruara;
 - c) vendosja e pedanave dhe tapeteve në hapësira publike të investuara ose të rikonstruara;
 - ç) vendosja në fasadat e objekteve ku ushtrohet aktiviteti tregtar i elementeve dhe pajisjeve teknike, përfshirë tubat e aspirimit, të cilat duhet të integrohen brenda objektit ose të vendosen në pjesët e sipërme të tij në lartësi të pranueshme, në mënyrë që të mos cenojnë estetikën urbane
- **Masa e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe distancat.** Masa maksimale e lejuar për shfrytëzimin e hapësirës publike përcaktohet sipas llojit të hapësirës, **Trotuarit:** Deri në 30% të gjerësisë së trotuarit, duke garantuar në çdo rast një hapësirë të lirë dhe pa pengesa, me gjerësi minimale prej 200 cm për lëvizjen e lirë të këmbësorëve. **Sheshet:** Deri në 30% të thellësisë së sheshit, por jo më

shumë se 10 (dhjetë) m thellësi frontazhi, paralel me fasadën e objektit, duke garantuar në çdo rast një hapësirë të lirë me gjerësi minimale prej 200 cm për lëvizjen e lirë të këmbësorëve. Këto dimensione janë të ilustruara me skicë tip.

➤ **Dokumentacioni dhe procedura e aplikimit për leje.**

- Kërkesën për aplikim sipas formularit tip; sipas *Aneksi 3* bashkëlidhur kësaj rregulloreje.
- Genplanin që pasqyron gjendjen ekzistuese dhe atë të propozuar.
- Planimetrinë, pamjet dhe prerjet e projektit, të firmosura dhe të vulosura nga projektues të licencuar.
- Fotografitë e gjendjes ekzistuese, ku paraqitet qartë konteksti urban.
- Vizualizime grafike (rendera) të projektit të propozuar, të firmosura dhe të vulosura nga projektues të licencuar.
- Dokumentin që provon pronësinë ose qiranë e objektit ku ushtrohet aktiviteti
- Vërtetimin që subjekti nuk ka detyrime tatimore të papaguara ndaj Bashkisë.

Shqyrtimi i aplikimit dhe vendimmarrja përfundimtare realizohen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga momenti i dorëzimit të dokumentacionit të plotë.

- **Afati i lejes.** Afati i lejes për shfrytëzimin e hapësirave publike për aktivitete gastronomike dhe/ose rekreative është deri në 1 (një) vit. Këshilli bashkiak miraton lejet për shfrytëzimin e hapësirave publike në rastet kur afati i kërkuar nga aplikuesi është mbi 1 (një) vit, por jo me shumë se 5 (pesë) vjet. Afati i lejes mund të rinovohet. Kërkesa për rinovim depozitohet të paktën 3 (tre) muaj para përfundimit të afatit të lejes në fuqi. Subjekti ka të drejtë të heqë dorë vullnetarisht nga leja për shfrytëzimin e hapësirave publike

KREU IV SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR EKSPOZIMIN E NJË KATEGORIE TË KUFIZUAR MALLRASH JASHTË NJËSISË SË TREGTIMIT

- Në këtë kre përcaktohen rregullat, kriteret dhe procedurat për shfrytëzimin e hapësirës publike për ekspozimin e një kategorie të kufizuar mallrash nga subjektet tregtare, jashtë ambienteve të njësisë së tregtimit, me synim lehtësimin e aksesit të klientëve, gjallërimin e jetës urbane dhe përdorimin e kontrolluar të hapësirës publike

Aktivitetet e lejuara.

- a) fruta dhe perime të freskëta; b) lule dhe bimësi dekorative; c) libra, revista dhe artikuj të ngjashëm; ç) produkte artizanale dhe suvenire të vogla; d) artikuj të përditshëm të konsumit të përmasave të vogla, që shërbejnë si plotësim i aktivitetit tregtar të njësisë

Pajisjet e lejuara dhe kriteret teknike

1. Pajisjet e lejuara për ekspozim përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

- a) rafte, stenda ose banakë të çmontueshëm dhe të vetëqëndrueshëm, të punuar me materiale të harmonizuara me hapësirën publike;
- b) kosha ose enë të lehta për fruta, perime apo lule;
- c) stenda vertikale të ulëta për libra e revista;
- ç) elemente hijezuese të lëvizshme dhe të çmontueshme, të palidhura me fasadën e objektit dhe me impakt vizual të ulët.

2. Pajisjet duhet të plotësojnë kriteret teknike, si më poshtë vijon:

- a) Të mos fiksohen në tokë ose në fasadë;
- b) Të kenë lartësi maksimale deri në 100 cm kur vendosen në hapësirë të lirë dhe deri në 180 cm kur mbështeten në fasadë;
- c) Të vendosen jo më larg se 1 (një) metër nga fasada e njësisë tregtare;

KREU V SHFRYTËZIMI I HAPËSIRËS PUBLIKE – TREGJE DHE AKTIVITETE AMBULATORE

- Ky kre përcakton rregullat, kriteret dhe kushtet për shfrytëzimin e hapësirave publike për zhvillimin e tregjeve dhe aktiviteteve ambulante, me qëllim ofrimin e mallrave dhe shërbimeve për qytetarët, në përputhje me standardet e higjienës, sigurisë, estetikës urbane, si dhe garantimin e lëvizjes së lirë e të pandërprerë të këmbësorëve

➤ *Aktivitetet e lejuara*

- Organizimi i tregjeve të përkohshme ose sezonale për produkte ushqimore, artizanale, bujqësore dhe mallra të ngjashme;
- Shitja ambulante e produkteve të lejuara, përmes karrocave, stendave të lëvizshme apo biçikletave tregtare, duke përfshirë fruta, perime, lule, akullore, suvenire, produkte artizanale të vogla dhe të tjera të ngjashme.

KREU VI SHFRYTËZIMI I DISA HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR VENDOSJEN E STRUKTURAVE TË LËVIZSHME

Ky kre përcakton kushtet dhe rregullat për vendosjen e strukturave të përkohshme të lëvizshme në hapësira publike të përcaktuara nga bashkia, me qëllim ofrimin e shërbimeve ose mallrave për qytetarët, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pa cenuar lëvizjen e lirë të këmbësorëve, higjienën, sigurinë dhe estetikën e hapësirës publike

- *Aktivitetet e lejuara.* a) shitja e gazetave, librave, revistave dhe materialeve të ngjashme; b) shitja e produkteve të vogla ushqimore të paketuara; c) shitja e suvenireve, kartolinave, artikujve artizanale dhe produkteve të ngjashme; ç) ofrimi i shërbimeve të vogla asistuese, përfshirë informacion turistik dhe shitje të biletave të transportit urban.
- *Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat.* Strukturat duhet të jenë të lëvizshme, të çmontueshme dhe të vetëqëndrueshme. Dimensionet maksimale: Gjatësi: 2,5 m; Gjerësi: 1,5 m; Lartësi: 2, m.
- *Masa e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe distancat.* Hapësira e zënë nga një strukturë e lëvizshme nuk mund të kalojë 6 (gjashtë) m² dhe duhet të jetë në përputhje me tipologjinë e miratuar, me përmasa sipas pikës 2, të nenit 51, të kësaj rregulloreje. Streha e saj nuk lejohet të dalë më shumë se 50 centimetra nga trupi i saj, ndërsa sipërfaqja e reklamës nuk mund të kalojë sipërfaqen më shumë se 1 m² dhe duhet të jetë e integruar në strukturë.
- *Ndalimet.* Shfrytëzimi i hapësirës publike ndalohet në rastet, kur: a) bëhet pengesë për shikimin e sinjalistikës rrugore; b) dëmton dhe cenon dekorin/estetikën e qytetit; c) bie në kundërshtim me interesat e komunitetit; ç) bie në kundërshtim me distancën e sigurisë me stacionet e karburanteve e cila nuk mund të jetë më pak se 5 m distancë nga zona e shërbimit; d) në hapësirat përpara Monumenteve të Kulturës nuk ruhet një hapësirë e konsiderueshme e cila garanton mospengimin e shikimit të monumentit; e) realizohet përpara institucioneve publike; ë) realizohet në hapësirat me vlera të larta historike, me karakteristika të veçanta, përveçse në rastet kur jepet leje që garanton lëvizjen e lirë të këmbësorëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi; f) realizohet në kryqëzimet me dhe pa semafor. Në këto raste shfrytëzimi i hapësirës publike bëhet vetëm jashtë trekëndëshit të shikimit; g) realizohet në një distancë tre (3) m në afërsi të rampave apo shkallëve që përdoren për akses; h) realizohet vendosja e tyre në zona të gjelbëruara të qytetit.

KREU VII SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR VENDOSJEN E STRUKTURAVE REKLAMUESE (STRUKTURA TË TIPIT *CITY LIGHT* DHE TABELAT REKLAMUESE *LED*)

- Ky kre përcakton rregullat dhe kushtet për mënyrën e shfrytëzimit të hapësirave publike nga subjektet që ushtrojnë aktivitete reklamuese ose që synojnë të reklamojnë biznesin e tyre përmes vendosjes së strukturave reklamuese të tipit *City Light* dhe tabelave reklamuese *LED* në hapësira publike, me qëllim informimin dhe promovimin e shërbimeve apo produkteve, duke ruajtur estetikën, sigurinë dhe funksionalitetin e hapësirës publike
- *Pajisjet e lejuara, format, materialet dhe ngjyrat.* Struktura *City Light* me dimensione standarde deri në 1,2 m gjerësi dhe 2,2 m lartësi. a) Tabelat reklamuese *LED* me sipërfaqe maksimale 6 m². b) Materiale rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe vandalizmit, të cilat garantojnë qëndrueshmëri dhe siguri gjatë gjithë kohëzgjatjes së përdorimit. c) Ndriçimi i strukturave reklamuese duhet të jetë i kontrolluar dhe i drejtuar vetëm mbi sipërfaqen e reklamës, në mënyrë që të shmangë verbimin, shpërqendrimin ose çdo rrezik për qarkullimin e automjeteve dhe këmbësorëve. Çdo ndryshim, modifikim ose përdorim i pajisjeve jashtë specifikimeve të mësipërme duhet të miratohet paraprakisht nga bashkia, në përputhje me aktet nënligjore dhe rregulloret teknike në fuqi.

KREU VIII SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE – FASADA PËR VENDOSJEN E TABELAVE REKLAMUESE

- **Ky kre përcakton** rregullat dhe kushtet për vendosjen e tabelave reklamuese në fasadat e ndërtesave që kufizojnë hapësirat publike, në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi. Qëllimi i këtij është promovimi i produkteve, shërbimeve ose aktiviteteve, duke garantuar:
 - a) sigurinë e përdoruesve të hapësirave publike;
 - b) ruajtjen e estetikës urbane dhe të integritetit vizual të qytetit;
 - c) integritetin e fasadave dhe elementeve arkitektonike ekzistuese.
 Fasadat e ndërtesave, që kufizojnë trotualet, sheshet, rrugët dhe çdo hapësirë tjetër publike, konsiderohen pjesë e hapësirës publike për shkak të ndikimit të tyre të drejtpërdrejtë në imazhin urban, perceptimin qytetar dhe sigurinë e lëvizjes.
- **Aktivitetet e lejuara promovimin e produkteve dhe shërbimeve tregtare;**
 - a) promovimin e produkteve dhe shërbimeve tregtare
 - b) promovimin e aktiviteteve kulturore, sociale, sportive dhe publike;
 - c) njoftimet e institucioneve publike dhe bashkive për interesa qytetare.
- **Ndalohet vendosja e tabelave që:**
 - a) promovojnë produkte të duhanit, alkoolit ose me përmbajtje të paligjshme;
 - b) shfaqin përmbajtje diskriminuese, të dhunshme, pornografike apo që cenojnë rendin dhe moralin publik;
 - c) mbulojnë elemente arkitektonike të fasadave me vlerë historike ose kulturore, pa miratimin e institucionit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
 - ç) vendosen në fasadat e ndërtesave të banuara pa miratimin e administratorit të ndërtesës dhe në përputhje me ligjin për administrimin e bashkëpronësisë;
 - d) përmbajnë mesazhe politike jashtë periudhave të përcaktuara ligjërisht për fushatat zgjedhore;
 - e) përdorin ndriçim verbues ose efekte dinamike që krijojnë rrezik për sigurinë rrugore ose shqetësim për banorët

KREU IX SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR ZHVILLIMIN E PANAIREVE DHE VENDOSJA E VEPRAVE ARTISTIKE DHE PËRKUJTIMORE

- Ky kre përcakton kushtet dhe rregullat për shfrytëzimin e hapësirave publike për organizimin e panairove të përkohshme, të cilat mund të kenë karakter tregtar, kulturor, artizanal, gastronomik, turistik, promovues apo të ofrimit të shërbimeve të ndryshme. Panairët kanë gjithmonë karakter të përkohshëm dhe nuk mund të zgjasin më shumë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike
- **Aktivitetet e lejuara dhe të ndaluara.** Lejohet organizimi i panairove të përkohshme për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme tregtare, artizanale, gastronomike, si dhe panairove të librit, artit, turizmit dhe kulturës. **Nuk lejohet** organizimi i panairove që përfshijnë tregtimin ose ekspozimin e produkteve të paligjshme ose të paregjistruara, si dhe të produkteve që mund të cenojnë shëndetin publik pa miratime të vlefshme higjieno-sanitare. Gjithashtu, ndalohet zhvillimi i panairove ose veprimtarive që cenojnë rendin publik, sigurinë, funksionalitetin ose estetikën e hapësirës publike, duke respektuar normat ligjore dhe rregulloret vendore në fuqi. Panairët në zona historike, monumente kulture ose në hapësira brenda zonave të mbrojtura mjedisore lejohen vetëm për qëllime kulturore/artizanale/turistike, për qëllime mjedisore apo për promovim të zonave të mbrojtura mjedisore, etj. Nuk lejohet mbipopullimi i hapësirës publike përtej sipërfaqes së përcaktuar në planin e miratuar të panairit. Ndalohet përpunimi i ushqimeve të përgatitura në vend pa përmbushur kushtet higjieniko- sanitare të miratuara, në mënyrë që të shmangët ndotja dhe rreziku për shëndetin publik. Ndalohet vendosja e materialeve ose mesazheve që nxisin dhunë, diskriminim ose urrejtje ose përmbajnë propagandë në kundërshtim me ligjin.

KREU X SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE PËR AKTIVITETE PROMOVUESE, ARTISTIKE, KULTURORE, AKTIVITETE POLITIKE E TË TJERA

- Ky kre rregullon kushtet, kriteret dhe procedurat për shfrytëzimin e hapësirave publike për zhvillimin e aktiviteteve promovuese, artistike, kulturore, edukative, sociale, fetare, politike dhe të tjera me ndikim publik. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është gjallërimi i jetës qytetare, nxitja e pjesëmarrjes publike dhe shfrytëzimi i hapësirave publike në mënyrë funksionale, të sigurt dhe estetike, në përputhje me integritetin urban dhe interesin e përgjithshëm

- Ndalimi i Shfrytëzimit të hapësirës publike në rastet e:
 - a) zhvillimit të aktivitetit në hapësirë publike pa leje për shfrytëzimin e hapësirës publike të bashkisë;
 - b) shfrytëzimit të hapësirës për qëllime të tjera nga ato të miratuara;
 - c) vendosjes së strukturave të përhershme;
 - ç) përdorimit të pajisjeve fonike mbi normat ligjore dhe ndriçimit verbues;
 - d) përdorimit të hapësirës për magazinim mallrash, ambalazhesh ose mbeturinash jashtë hapësirave të përcaktuara;
 - dh) aktiviteteve që cenojnë qarkullimin ose sigurinë publike duke përfshirë bllokimin e korridoreve të emergjencës;
 - e) shitjes ose ekspozimit të mallrave jashtë tipologjisë së miratuar në leje;
 - f) organizimit të aktiviteteve me përmbajtje diskriminuuese, të dhunshme, pornografike ose që nxisin urrejtje mbi baza racore, fetare, etnike, politike etj.;
 - g) përdorimit të fishekzjarrëve, piroteknikëve ose materialeve të rrezikshme pa autorizim të posaçëm.

KREU XI SHFRYTËZIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE (TROTUARE) GJATË NDËRTIMIT

- Ky kre përcakton kushtet, kriteret dhe rregullat për shfrytëzimin e hapësirave publike, veçanërisht trotuareve dhe zonave të tjera të aksesit publik, gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit, rikonstruksionit ose mirëmbajtjes së objekteve. Shfrytëzimi i këtyre hapësirave lejohet vetëm në rastet kur është i domosdoshëm për kryerjen e punimeve dhe nuk ekzistojnë zgjidhje alternative teknike që e shmangin atë. Shfrytëzimi i trotuareve duhet të jetë gjithmonë i përkohshëm dhe për aq kohë sa zgjat aktiviteti i ndërtimit, duke garantuar, në çdo rast, sigurinë e këmbësorëve dhe aksesin e tyre të pandërprerë përmes rrugëve ose kalimeve alternative të sigurta
- **Aktivitetet e lejuara.** Vendosja e skelave për punime ndërtimore ose restauruese, në përputhje me standardet teknike dhe të sigurisë.
Vendosja e barrierave mbrojtëse dhe rrethimeve të përkohshme për sigurimin e zonës së punimeve. Shtrirja e përkohshme e materialeve ndërtimore, vetëm në hapësirat e përcaktuara në leje, duke garantuar gjithmonë një korridor minimal prej 200 cm për kalimin e këmbësorëve
Vendosja e sinjalistikës paralajmëruese dhe ndriçimit mbrojtës veçanërisht gjatë natës.
Organizimi i korridoreve të sigurta dhe të mbrojtura për kalimin e përkohshëm të këmbësorëve, të aksesueshme edhe për persona me aftësi të kufizuara. Mirëmbajtja e përditshme e hapësirës së shfrytëzuar.
- **Pajisjet e lejuara,** format, materialet dhe ngjyrat. Të vendosë skela të certifikuara. Të vendosë rrethime të përkohshme, të ndërtuara me panele metalike ose materiale të tjera të sigurta. Të vendosë tabela identifikuese në vend të dukshëm.

KREU XII DISPOZITA TË FUNDIT

Miratimi i kësaj rregulloreje sjell si pasoje shfuqizimin e Vendimit Këshillit të Bashkisë Nr.23 date 31.03.2022 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe rregullat e zenies se hapësirës publike në Bashkinë Përmet"

Miratimi i formateve tip për lejen e shfrytëzimit të hapësirës publike (*Aneksi 1*), preces-verbalet e konstatimit të shkeljes së hapësirës publike (*Aneksi 2*), kërkesat e subjekteve për shfrytëzimin e hapësirës publike (*Aneksi 3*),

VI. ARSYETIMI I PROPOZIMIT

Hartimi dhe miratimi i kësaj rregulloreje vjen si domosdoshmëri për shkak të:

- Mungesës së një kuadri të unifikuar dhe të detajuar rregullator;
- Nevojës për të parandaluar zënien e paligjshme të hapësirave publike;
- Kërkesave në rritje nga subjektet private për përdorim të hapësirave;
- Përmirësimit të imazhit urban dhe zhvillimit ekonomik lokal.
-

VII. NDIKIMI FINANCIAR

Zbatimi i rregullores pritet të:

- Rrisë të ardhurat vendore nga tarifat;
- Ulje informalitetin;
- Mirënjohje menaxhimit financiar të aseteve publike;
- Reduktojë kostot e ndërhyrjeve për lirimin e hapësirave të zëna në mënyrë të paligjshme.

IX. KONKLUSIONE DHE PROPOZIM

Në përfundim, duke vlerësuar rëndësinë e menaxhimit të qëndrueshëm të hapësirave publike dhe nevojën për rregullim të qartë ligjor, propozohet që Këshilli i Bashkisë:

- Të shqyrtojë projekt-rreguloren “Për shfrytëzimin e hapësirës publike”;
- Të miratojë këtë rregullore si akt normativ vendor;
- Të ngarkojë strukturat përkatëse për zbatimin dhe monitorimin e saj.

Në nenin Neni 126 **Aktet nënligjore** të VKM nr 224 *citohet*: Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë detyrimin që, në zbatim të kësaj rregulloreje, të nxjerrin aktet nënligjore dhe dokumentet ndihmëse të nevojshme brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, duke garantuar zbatimin e saj si dhe transparencë e akses publik.

Sa më lart, i propozojmë Këshillit Bashkisë miratimin e rregullores “Për Kushtet dhe rregullat e zënies së hapësirës Publike”. Me miratimin në Këshillin e Bashkisë Permet të kësaj rregulloreje do të behet i mundur përdorimi sipas kushteve, dhe sa me uniforme i hapësirave publike në Bashkinë Permet.

Duke shprehur në miratimin e kësaj projekt-rregullore nga ana Juaj,

HARTUESIT E KËTIJ PROJEKT-VENDIMI

Adminstrator i Shërbimeve Publike: Arian JAUPI

Zyra Juridike, Juristi: Enea KUSHE

Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe Turizmit: Etleva MYFTARI

Drejtori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit: Ing. Laert BUSHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET**

P/VENDIM

Nr. ___ datë ___ / ___ 2026

PËR

MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT STRATEGJIK VENDOR PËR RININË 2026-2029 BASHKIA PËRMET

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar; Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit Nr.68/2017 «Për financat e vetqeverisjes vendore »; Ligjit Nr.10296 datë 08.07.2010 «Për menaxhimin financiar dhe kontrollin» i ndryshuar; Ligji nr 75/2019 “Për Rininë”; Ligji nr 25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e start-up-eve”; Strategjinë Kombëtare për Rininë 2022–2029; Kontrata Nr.3537 Prot date 24.10.2025 midis Bashkisë Përmet dhe Shoqatës “MKEZH”; Urdhër Nr.471 datë 07.11.2025 “Për emërimin e antarëve të Këshillit Vendor të Rinisë në Bashkinë Përmet”; Këshilli Bashkiak, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin Strategjik Vendor për Rininë 2026-2029 Bashkia Përmet.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë, Turizmit dhe Rinisë dhe Drejtoria e Projekteve, Integritimit Evropian, Performancës dhe Dixhitalizimit të të Dhënave.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET**

RELACION

**PËR
MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT STRATEGJIK VENDOR PËR RININË
2026-2029 BASHKIA PËRMET**

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar; ,Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit Nr.68/2017 «Për financat e vetqeverisjes vendore »; Ligjit Nr.10296 datë 08.07.2010 «Për menaxhimin financiar dhe kontrollin» i ndryshuar; Ligji nr 75/2019 “Për Rininë”; Ligji nr 25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e start-up-eve”; Strategjinë Kombëtare për Rininë 2022–2029; Kontrata Nr.3537 Prot date 24.10.2025 midis Bashkisë Përmet dhe Shoqatës “MKEZH”; Urdhër Nr.471 datë 07.11.2025 “Për emërimin e antarëve të Këshillit Vendor të Rinisë në Bashkinë Përmet”;

Plani Strategjik Vendor për Rininë 2026–2029 përbën një dokument të rëndësishëm strategjik, i cili synon orientimin e politikave dhe ndërhyrjeve të Bashkisë Përmet në fushën e rinisë, duke vendosur të rinjtë në qendër të zhvillimit social dhe ekonomik të territorit. Plani Rinisë krijon një vizion për vitet e ardhshme në krijimin e kushteve dhe një mjedisi të sigurt social, shëndetësor dhe politik, për një rini me aktive dhe të barabartë në të gjitha fushat e jetës dhe me status të konsoliduar për të ardhmen e tyre.

Hartimi i këtij plani është realizuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, në veçanti me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligjin nr. 79/2019 “Për rininë”, si dhe në harmoni me dokumentet strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e rinisë.

Ky dokument është hartuar në bashkëpunim me Shoqatën Multifunkionale për Kulturë, Edukim dhe Zhvillim (MKEZH), në kuadër të zbatimit të projektit “Të rinjtë që sjellin ndryshimin në Përmet”, Programi Reload 2, me financim të Bashkisë Përmet. Procesi i hartimit është mbështetur në një qasje gjithëpërfshirëse, duke përfshirë konsultime të drejtpërdrejta me të rinjtë, përmes pyetësorëve dhe takimeve konsultative, me qëllim identifikimin e nevojave dhe prioritetëve reale të tyre. Pasi është realizuar vlerësimi i situatës, mbledhja e të dhënave, seleksionimi informacionit në Bashkinë Përmet, me konsultime dhe takime të herë pas hershme me përfaqësues të Bashkisë, të rinj, Këshillin Vendor Rinor, institucioneve vendore, u përcaktuan drejtimitet e ndërhyrjes në këtë fushë, duke hartuar dhe planin e masave që do të ndërmerren për periudhën 3-vjeçare 2026-2029.

Nga analiza e situatës rezulton se sfidat kryesore me të cilat përballen të rinjtë në Bashkinë Përmet lidhen me emigrimin, papunësinë dhe mungesën e mundësive për zhvillim profesional, si dhe me nivelin e pamjaftueshëm të përfshirjes në proceset vendimmarrëse.

Plani ndërtohet mbi pesë shtylla kryesore zhvillimi:



- ✓ HAPËSIRAT DHE INFRASTRUKTURA RINORE
- ✓ PUNËSIMI DHE SIPËRMARRJA RINORE
- ✓ PJESEMARRJA DHE PËRFAQËSIMI RINOR NË VENDIMMARRJEN LOKALE
- ✓ ZHVILLIMI I AKTIVITETEVE KULTURORE, SPORTIVE DHE HAPËSIRAVE RINORE;
- ✓ MIRËQENIA SOCIALE DHE SHËRBIMET PUBLIKE PËR TË RINJTË.

Nëpërmjet këtyre prioriteteve, plani synon krijimin e mundësive konkrete për aftësim, punësim dhe angazhim qytetar të të rinjve, duke kontribuar në reduktimin e faktorëve që nxisin largimin e tyre dhe në forcimin e rolit të rinisë si aktor kyç në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit.

Dokumenti përmban objektiva të qarta, masa konkrete, indikatorë të matshëm dhe mekanizma monitorimi e vlerësimi, të cilat garantojnë zbatimin efektiv dhe transparent të tij gjatë periudhës 2026–2029. Në përfundim, miratimi i Planit Strategjik Vendor për Rininë 2026–2029 përbën një hap të rëndësishëm drejt fuqizimit të rinisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm social dhe ekonomik të Bashkisë Përmet.

Për sa më sipër, propozohet miratimi i Planit Strategjik Vendor për Rininë 2026–2029 nga Këshilli Bashkiak Përmet.

Personi përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të planit Strategjik Vendor të Rinisë, në këtë rast Këshilli Vendor Rinor dhe Specialisti Turizmit dhe Rinisë, paraqet para Këshillit Bashkiak një raport mbi zbatimin e planit.

DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, BUJQËSISË, TURIZMIT DHE RINISË

Etleva Myftari

Specialist i Turizmit Dhe Rinisë

Kristiana Thodhori

DREJTORIA E PROJEKTEVE, INTEGRIMIT EVROPIAN, PERFORMANCES DHE DIXHITALIZIMIT TE TE DHENAVE

Klaudja Ciko



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr _____ Prot

Datë _____ .2026

Për

**MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT REZERVË PËR DHËNIE
NDIHME FINANCIARE**

Bazuar në Ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore ", Ligjin Nr. 68 /2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore ", Ligjin 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë "i ndryshuar, Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar , Ligji Nr.87/2025 "Për Buxhetin e vitit 2026", Vendimi i KB Nr.113 datë 17.12.2025 "Për Buxhetin e Bashkisë Përmet viti 2026" dhe përcaktimin e numrit të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj" ,Këshilli Bashkiak me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

V E N D O S I

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë për shpenzime buxhetore të paplanifikuara (për dhënie ndihme financiare) në masën 360.000 (treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë. për sa më poshtë vijon:

1 Ëngjëllushe Canollari të ndimohet përkatësisht në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.

- | | | |
|--------------------|------------------------------------|---------------------------------|
| 2 Artan Stefani | të ndimohet përkatësisht në shumën | 30.000 (dhjetë mijë) lekë |
| 3 Përparim Malkë | të ndimohet përkatësisht në shumën | 30.000 (tridhjetë mijë) lekë. |
| 4 Yllkë Çobani | të ndimohet përkatësisht në shumën | 30.000 (tridhjetë mijë) lekë. |
| 5 Astrit Osmani | të ndimohet përkatësisht në shumën | 30.000 (tridhjetë mijë) lekë. |
| 6 Gladionë Marku | të ndimohet përkatësisht në shumën | 30.000 (tridhjetë mijë) lekë. |
| 7 Adelina Peçi | të ndimohet përkatësisht në shumën | 30.000 (tridhjetë mijë) lekë. |
| 8 Vjollca Mustafaj | të ndimohet përkatësisht në shumën | 30.000 (tridhjetë mijë) lekë. |
| 9 Albana Naqe | të ndimohet përkatësisht në shumën | 30.000 (tridhjetë mijë) lekë. |
| 10 Florida Çumani | të ndimohet përkatësisht në shumën | 30.000 (tridhjetë mijë) lekë. |

- 11 Nafis Murataj të ndimohet përkatësisht në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.
12 Dhimitër Meshini të ndimohet përkatësisht në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.

2. Miratimin e transferimit buxhetor si më poshtë :

Pakësim në strukturën buxhetore :

GR 00,TIT AF135,KAP 05,ART 609,Kod Produkti V494AAA në shumën 360.000 lekë

Shtesa në strukturën buxhetore :

GR 00,TIT AF135,KAP 05,ART 606,Kod Produkti V494AAA në shumën 360.000 lekë

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhet-Financës dhe Tatim –Taksa/Spektori i Buxhet Financës.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR I BASHKISË

Alm HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Përmet, më ____ . ____ . 2026

RELACION
DREJTUAR
KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar këshilltarë!

Shtetësja Engjëllushe Canollari ,banuese në Përmet ka bërë kërkesë Nr.1329 Prot datë 08.04.2026 pranë bashkisë për t'u ndihmuar financiarisht pasi është në kushte shumë të vështira ekonomike,dhe me sëmundje tumorale dhe duhet të përballojë shpenzimet e kurimit dhe kimjot që bën .

Pranë bashkisë është paraqitur kërkesë me Nr.1275 Prot datë 03.04.2026 nga shtetasi Artan Stefani banues në Përmet i cili kërkon tyë ndimohet financiarisht nga bashkia pasi ka nënën e sëmurë dhe shpenzimet për kurimin e saj janë të mëdha dhe nuk I përballon dot.

Edhe shtetasi Përparim Malkë banues në Pacomit ka paraqitur kërkesë Nr.1128 Prot datë 24.03.2026 pranë bashkisë për t'u ndihmuar financiarisht pasi është person,pa punë, në kushte të vështira ekonomike i sëmurë dhe nuk ka të ardhura të mjaftueshme për të përballuar jetesën dhe shpenzimet për kurimin e tij.

Shtetësja Yllkë Çobani banuese në Përmet ka paraqitur kërkesë Nr.1170 Prot datë 26.03.2026 pranë bashkisë për t'u ndihmuar financiarisht pasi është e vetmuar ,e sëmurë e paralizuar,e braktisur nga fëmijët dhe nuk ka të ardhura për të përballuar shpenzimet për të blerë ilaçet shëndetësore.

Shtetësi Astrit Osmani banues në Njësinë Administrative Piskovë ka paraqitur kërkesë Nr.982 Prot datë 11.03.2026 pranë bashkisë për t'u ndihmuar financiarisht pasi ka pësuar një aksident dhe i janë dëmtuar të dy këmbët dhe nuk ka të ardhura për të përballuar shpenzimet për blerjen e ilaçeve dhe jetesën.

Shtetësja Adelina Peçi banuese në Përmet ka paraqitur kërkesë Nr.1135 Prot datë 19.03.2026 pranë bashkisë për t'u ndihmuar financiarisht pasi është e sëmurë ,me problem të shëndetit mendor,me KEMP dhe nuk ka të ardhura për të përballuar jetesën.

Pranë bashkisë ka paraqitur kërkesë Nr.1146 Prot datë 25.03.2026 edhe shtetësia Gladionë Marku banuese në Përmet e cili kërkon të ndihmoet financiarisht pasi është person invalide dhe pagesa që përfiton nuk i del për të përballuar jetesën.



Edhe shtetësja Violca Mustafaj ka paraqitur kërkesë Nr.1499 Prot datë 21.04.2026 pranë bashkisë për tu ndihmuar financiarisht pasi është e sëmurë ,ka dhe djalin me problem të shëndetit mendor dhe nuk ka të ardhura të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet për blerjen e ilaçeve të tij.

Shtetësja Albana Naqe ka paraqitur kërkesë Nr.1498 Prot datë 21.04.2026 pranë bashkisë për tu ndihmuar financiarisht pasi është e sëmurë me tumor dhe kurimi për kimiot që bën është shumë I kushtueshëm dhe nuk ka mundësi për ti përballuar ato.

Pranë bashkisë ka paraqitur kërkesë Nr.1501 Prot datë 21.04.2026 edhe shtetësja Florida Çumani e cila kërkon të ndihmoet financiarisht nga bashkia pasi ka vajzën të sëmurë dhe vetë është e sëmurë dhe shpenzimet për blerjen e ilaçeve janë të mëdha dhe nuk ka mundësi financiare për blerjen e tyre.

